



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 6
Prishtinë, më 25.3. 2014, në orën 10:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-3

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali, kryetare, Rita Hajzeraj - Beqaj, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Justina Pula, Kymete Bajraktari, Kimete Bytyçi dhe Duda Balje.

Mungoi: Justina Pula-Shiroka.

Të ftuar: Sami Salihu, drejtor i Departamentit të Pensioneve, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Enver Kurtalani, Shoqata e të Shurdhërve të Kosovës.

Nga Staf i mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi, koridnator dhe Sulltane Gashi, zyrtare ligjore.

Pjesëmarrës të tjerë: Basri Berisha-IAP, Nebih Preniqi-SHKSH, Lejla Selimi-OSBE, Nuredin Ibishi - UNDP, Ibush Fazliu-MPMS-DPSF, Sadije Asllani-MPMS/DAPK, Isuf Ajeti-MPMS/DAPK, Rukije Gashi-SHKSH, Bujar Kadriu-SH.V.K dhe Ibish Sylejmani-SH.V.K.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.3. 2014;
3. Shqyrtimi i zbatimit të Ligjit për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar në Kosovë, respektivisht përjashtimi i personave të shurdhër nga skema pensionale. Të ftuar përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
4. Shqyrtimi i Peticioneve;
5. Të ndryshme.

Suzan Noberdali, kryetare, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e trete të rendit të ditës, për arsye që palët e ftuara mos të presin.

3. Shqyrtimi i zbatimit të Ligjit për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar në Kosovë, respektivisht përjashtimi i personave të shurdhër nga skema pensionale. Të ftuar përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Suzan Noberdaliu, kryetare, tha se për këtë mbledhje kemi ftuar prapë përfaqësuesit e MPMS-së dhe ata të Shoqatës Kosovare të të Shurdhërve, që të na japin sqarime për largimin e personave nga skema pensionale, sepse herën e kaluar kemi parë lëndët me arsyetim shumë të shkurtër, pa dhënë sqarime të duhura. Ajo tha se këta persona, nga viti 2004 janë paguar e pas 10 viteve janë refuzuar, me ç'rast thuhet se aftësia e kufizuar nuk është e plotë dhe e përhershme, me çka është konstatuar se nuk është e përhershme, duke pyetur se në çfarë prova janë bazuar për marrjen e një vendimi të tillë.

Sami Salihu, drejtor i Departamentit të Pensioneve në MPMS-së, tha se sipas marrëveshjes nga takimi i kaluar, kemi siguruar lëndët sipas kërkesës së shoqatës që e kishin bërë listën me 17 persona dhe i kemi sjellë 17 lëndë.

Disa persona janë refuzuar vetëm në shkallën e parë. Kanë bërë ankesë në shkallën e dytë që është në Prishtinë. Lëndët nuk janë të natyrës së njëjtë, mund ti shihni dhe pastaj të diskutojmë. Jam interesuar sa i përket vendimit që është përmendur në mbledhjen e kaluar dhe erdhëm në përfundim se Ministria nuk ka nxjerr vendim të veçantë për largimin e këtyre personave nga skema pensionale edhe pse, edhe atë ditë e kemi cekur që nuk ka vendim të tillë.

Sadije Asllani tha se 6 vite punon në komisionet mjekësore të MPMS-së, në vlerësimin e personave me aftësi të kufizuar, jo vetëm të kësaj kategorie që jemi ftuar.

Ajo tha se nuk është e vërtetë se të shurdhrit të gjithë nuk e kalojnë testin në komision. Të shurdhrit kanë aftësi të kufizuar sensitive, por jo të plotë. Në Kombinatin “Trepça”, personat e shurdhër kanë qenë punëtorët më të mirë.

Kryetarja Suzan Noberdali, tha se po të kemi një rast të shurdhërve dhe po t’i ketë ndodhur ndonjë aksident, me siguri do ta thërrisim mjekun, i cili është specialist për ORL-në, e që është kompetent për të vlerësuar. Nuk e di, mjekët tjerë që janë në komision çka kanë specializuar? A janë të gjithë të njëjtës fushë apo janë të specializuar saktësisht vetëm për vesh?

Sadije Asllani tha se në një komision punon një specialist i mjekësisë së punës, një internist, një oftalmolog, në tjetrin komision punon një specialist i punës, një internist dhe një psikiatër.

Për mjekun specialist të mjekësisë së punës do të thotë se të gjithë specialistët tjerë janë konsultantë, punojmë me një kategori të popullatës, e cila duhet të jetë e aftë për punë deri në moshën 65 vjeçare. Me ligj është dashur të bëhet kategorizimi i invaliditetit, kategoria e parë e dytë dhe e tretë. Të shurdhrit nuk kanë paaftësi të plotë, ata kanë aftësi të kufizuar pune. Ata për një fushë mund të jenë të paaftë por për shumë fusha të tjera janë të aftë.

Kymete Bajraktari tha se nuk po e kontestojmë atë a janë të aftë për të punuar, por a kanë aftësi të kufizuar dhe nëse janë persona me aftësi të kufizuar, a duhet të hiqen nga lista e pagesave të gjithë personat e tjerë me aftësi të kufizuar në Kosovë?

Kurtan Kajtazi pyeti se cili është kriteri që disa persona të shurdhër e kanë fituar të drejtën për pension dhe çfarë kriteri është përdorur që disa të fitojnë këtë të drejtë e disa jo.

Sadije Asllani tha se të shurdhrit kanë aftësi të kufizuar të punës. A kanë aftësi të kufizuar të plot, nuk kanë. A mund të krahasohen me të verbrit, mendoj se nuk mund të

krahasohen. Të verbrit varen nga personat tjerë, të shurdhrit nuk kanë nevojë për personin tjetër.

Kymete Bajraktari tha se a duhet këta të hiqen edhe prej listës prej termit aftësi e kufizuar, për shkak se janë të aftë për punë. Deri tash, ata i kanë gëzuar pensionet e aftësisë së kufizuar prej vitit 2004, edhe atëherë kanë qenë të aftë për punë. Tash po hiqen prej skemës pensionale se qenkan të aftë për punë. A kanë mundësi të punojnë? Kanë. Do të mund të gjejnë punë, megjithatë, këta janë persona me aftësi të kufizuar,

Sadije Asllani ritheksoi se këta persona kanë aftësi të kufizuar, por jo të plotë për të qenë në asistencën e kësaj kategorie për përfitime. Ajo tha se nuk refuzohen të gjithë personat dhe nuk përfitojnë të gjithë.

Kriteret që i kemi përdorur, kemi shtuar edhe diagnoza të tjera. Punon komisioni, por nuk është një komision adekuat, çfarë duhet të jetë. Ata që e kanë fituar kriterin për marrjen e pensionit, janë persona që janë të shurdhër, plus kanë edhe ndonjë paaftësi tjetër.

Sami Salihu theksoi se përfitues të këtij ligji të skemës pensionale, janë të gjithë ata persona që janë të paaftë, pra me aftësi të kufizuar të plotë dhe të përhershme. Këtë e specifikon ligji.

Enver Kurtalani tha se e kaluara çka ka ndodhur deri tash nuk i intereson. Ju intereson se çka po vendoset tani. Ai tha se në nenin 1, paragrafi 2, të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat me Aftësi të Kufizuara, shkruan se të gjithë personat me aftësi të kufizuar në ndërveprim me disa barriera të tjera, e pamundësojnë jetën në një shoqëri të mirë. Shteti obligohet që të respektojë këto konventa. Në njëërën anë, këta persona largohen nga skema pensionale, kurse në anën tjetër nuk respektohet ligji, se në çdo 50 punëtorë, i 51-njëti duhet me qenë person me aftësi të kufizuar.

Ai tha se nuk po kupton. Do t'ju lusja që ti shohim konventat dhe nenet që sigurojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, në këtë rast, ato për personat e shurdhër. Dua të dijë, kur do të kishit filluar një ditë të punoni dhe ti ktheni personat e shurdhër në skemën pensionale sepse kjo është e drejtë e tyre, ngase ka mundësi që këta persona do të rebelohen dhe do të ankohen në instancat më të larta, e edhe në Gjykatën e Strasburgut.

Rita Hajzeraj theksoi se është shumë shqetësuese kompletimi i komisionit mjekësor. Nëse ky komision nuk është komplet dhe nuk është kompetent për vlerësimin e këtyre personave, atëherë ministria ka dështuar në vlerësimin e personave me aftësi të kufizuar, që në mesin e tyre janë edhe këta persona.

Sadije Asllani tha se komisioni është adekuat, por se duhet të punojë me kategorizime të invaliditetit të shkallës së parë, të dytë dhe të tretë, dhe shtoi se i vjen keq që nga kjo kategori, nuk po përfitojnë të gjithë.

Rita Hajzeraj tha se ju referova fjalës suaj ashtu siç e keni thënë se komisioni, nuk është adekuat. Nuk dyshoj në vullnetin tuaj, ndoshta anëtarët tjerë nuk ju përgjigjen, nuk ju përgjigjet as ministria. Dhe, cili është arsyeja që ju iu keni dhënë këtyre njerëzve, që i keni refuzuar nga skema pensionale, kur të njëjtën e kanë përfituar deri tani. Atë arsyetimin që e pamë ne, është shumë i mangët. Si do të bëjnë ankesë këta persona, kur arsyetimi është tepër i mangët.

Sadije Asllani tha se kanë mundësi të ankesës në shkallën e dytë. Në shkallën e dytë ftohet specialisti i ORL-së dhe e jep mendimin e vet.

Isuf Ajeti tha se problemi është në çështjen e legjislacionit, aty është humbja e përhershme dhe e plotë e aftësisë, prej se kam punuar me komisione mjekësore, mjeku, specialisti i mjekësisë së punës, është ai kryesori për këtë, sepse ai merret me aftësinë punuese të çdo personi. Në shkallën e dytë, patjetër duhet të jetë specialisti i lëmit përkatës.

Kryetarja Suzan Novoberdaliu, tha se vet titulli i ligjit është shumë i qartë dhe është ligji për pensionet e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë, duke shtuar se ky ligj ose është shkelur në etapën e parë, ose po shkelet tani në etapën e dytë, sepse një e drejtë ju është njohur njëherë me të njëjtin ligj dhe pastaj po ajo e drejtë ju merret me të njëjtin ligj. Po shihet se diçka nuk është në rregull.

Rukije Gashi, përfaqësues e Shoqatës së të Shurdhërve të Kosovës, tha se me ministrin jemi zhgënjyer qysh herët dhe po ndihet e zhgënjyer edhe nga komisioni. Këta persona nuk kanë filluar të hiqen nga skema pensionale këtë vit por qysh prej vitit 2012. Sa i përket aftësisë së kufizuar të plotë, komisioni mjekësor e diskrediton në të gjitha mënyrat personin gjatë vlerësimit, madje duke e akuzuar se kur të jesh i aftë të bësh fëmijë, je i aftë edhe të punosh. Ky është një diskriminim shumë i madh.

Kryetarja tha se duhet te ftohet ministri në mbledhje të komisionit dhe të raportojë, pse kjo kategori po përjashtohet nga skema pensionale me një vendim të pashkruar

Nebih Preniqi, kryetar i Shoqatës të Shurdhërve të Kosovës, tha se kanë 12 shoqata që janë ndër këtë ombrellë. Për këta persona mjekët kanë konstatuar se janë persona me aftësi të kufizuar, që duhet të jenë në skemën pensionale dhe tash merr vendim krejt tjetër. Në çka bazohet kjo?

Kurtan Kajtazi tha se nuk është defekti te komisioni mjekësor dhe i mungesës së otorinolaringologut, sepse në shkallën e dytë është mjeku specialist përkatës. Por, pse nuk njihen këta persona si kategori me aftësi të përhershme dhe të plote është problem te ligji, i cili duhet të plotësohet dhe të ndryshohet dhe të bëhet kategorizimi i këtyre personave ose ministria të nxjerrë një udhëzim administrativ.

Kimete Bytyçi tha se me kategoritë e këtyre personave çka do te bëni si ministri më tutje, sepse nuk po respektohet ligji dhe nuk po ndërmerret asgjë. U tha që ne vendet e tjera këta persona kanë krejt trajtim tjetër dhe kanë pozita te avancuara aty ku punojnë e edhe në profesionin e mjekut. Pse te ne janë te pamundshme këto? Çka është në pyetje?

Ajo propozoi që të ftohet ministri në një mbledhje dhe të raportojë për problemet e këtyre personave.

Bujar Kadriu, Shoqata e të Verbërve të Kosovës, fillimisht njoftoi se në Kosovë është formuar Forumi Kosovar për Personat me Aftësi të Kufizuar, ku ai është emëruar kryetar. Ky tha se pajtohet me disa konstatime se ky është një defekt ligjor. Këto

probleme i kanë pasur edhe personat e verbër sepse nuk ke mundur të përfitosh vetëm si i verbër. Është dashur të kesh dokument shtesë nga kardiologu apo diçka tjetër të aftësisë së kufizuar të kombinuar, për të gëzuar të drejtën e shfrytëzimit të pensionit. Unë pajtohem me rekomandimin, që ky ligj urgjentisht të hyjë në procedurat e plotësimit dhe ndryshimit, apo MPMS-ja të nxjerr një vendim që komunitetit të të shurdhërve, t'u njihet e drejta e pensionit, të personave me aftësi të kufizuar.

Sadije Asllani tha se me shqetëson fakti, nëse dyshohet se kemi urdhra nga dikush. Nuk kemi urdhra. Në komisionin mjekësor jemi 6 persona dhe asnjë kontakt nuk e kemi pasur nga ministri.

Kryetarja Suzan Novoberdali, tha se ligjet si; për pensionet e personave me aftësi të kufizuar, për përkrahje familjarëve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuar dhe për aftësim dhe riaftësim të personave me aftësi të kufizuar, janë ligje që nuk i përkasin këtij komisioni, por i përkasin Komisionit për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Ajo tha se sidoqoftë, po ndërhyrë në kompetencat e komisioneve tjera, duke shfrytëzuar respektimin e të drejtave të njeriut, me vullnetin që të ndihmojmë kategori të caktuara, në këtë rast, personat e shurdhër.

Ajo propozoi që në takimin e radhës, në komision të ftohet ministri i MPMS-së, për këtë çështje dhe tha se në seancën e së enjtes do ta ngritë si çështje jashtë rendit të ditës dhe të sensibilizojmë opinionin, dhe kjo kategori të paguhet, ashtu siç është paguar deri më tash, deri në plotësimin dhe ndryshimin e ligjit.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura me 18 mars 2014;

Kryetarja Suzan Novoberdaliu, konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 18 mars 2014, u miratua pa vërejtje.

4.Shqyrtimi i Peticioneve;

Rita Hajzeraj-Beqaj tha se kemi një informate nga nisma legislative qytetare, për ndryshimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë. Ky ligj duhet të vijë për plotësim-ndryshim. Ne si komision po e përkrahim, meqenëse ata ende janë në fazën e mbledhjes së nënshkrimeve për peticion sepse deri tani janë mbledhur 1000 nënshkrime. Le të mblidhen të gjitha nënshkrimet, pastaj të procedohet sipas rregullave të parapara. Ajo tha se kjo lëndë në komision ka ardhur vetëm si informatë dhe ne si komision e përkrahim.

Ajo po ashtu tha se kemi një kërkesë nga fshataret e fshatit Gornje Sellë, që jetojnë në Prevallë, dhe aty ata e kanë pronën private në Parkun Kombëtar të Sharrit. Nuk janë konsultuar në lidhje me Ligjin për Parkun Kombëtar Sharri dhe frikohen që pronat e tyre do të mbesin pronë e Parkut Kombëtar dhe nuk do të kenë qasje në to.

Albana Gashi tha se ministria ka marrë vendim për rrënimin e staneve, shtëpive të vjetra të tyre. Ne si komision duhet të informohemi nga ministria se ku është problemi dhe të marrim informata lidhur me këtë.

Kryetarja konstatoi se komisioni unanimisht vendosi të nxjerr këtë:

Përfundim

Komisioni vendosi që këtë kërkesë ta dërgojë për shqyrtim për të dhënë sqarime në komisionin kompetent për Bujqësi, sepse ata janë komisioni kompetent për këto çështje. Pasi të informohemi në detaje se ku qëndron problemi, pastaj në komision do të vendosim se çka të ndërmerret më tutje.

6. Të ndryshme

Kryetarja Suzan Novoberdaliu tha se ka pasur një takim me Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, me ç'rast është mbajtur një tryezë, ku ka qenë e ftuar edhe ajo dhe ata janë ankuar se materialisht qëndrojnë jo mirë. Deri me tani, një pjesë janë financuar nga UNDP-ja, në disa zyra rajonale. Prej muajit prill, UNDP-ja më nuk do të mbështes këto zyra, dhe më nuk do të ketë ofrim të ndihmës juridike falas nga këto zyra, që kanë qenë të mbuluara financiarisht nga UNDP-ja.

Ajo tha se në këtë tryezë ka qenë i ftuar edhe ministri i Drejtësisë, z. Hajredin Kuqi dhe se ai ka premtuar se do ti përkrah financiarisht.

Në takimin e radhës është mirë t'i ftojme përfaqësuesit e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas dhe ministrin Kuqi, dhe të shohim se a do ta mbajë premtimin e dhënë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali